



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 14442 Prot.

Tiranë, më 18.10.2023

SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE “SEKRETAR GJYQËSOR”

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë, pranim në Shërbimin Civil, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritje në detyrë dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

15 (pesëmbëdhjetë) pozicione - Sekretar Gjyqësor, kategoria IV-1

Pozicionet më sipër, u ofrohet nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele, të gjykatave të kategorisë së parë (të lartë). Vetëm në rast se nga keto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezultojnë ende vakant, ato janë te vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për punonjësit e gjykatave të kategorisë së dytë (të mesme) dhe të tretë (të ulët) dhe në rast se nga këto pozicione në përfundim të këtyre dy procedurave rezultojnë ende vakant, ato janë te vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË: 02 Nentor 2023

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR: 09 Nentor 2023

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionet sekretar gjyqësor është:

- a. Dokumenton për të gjitha efektet, në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji, veprimtari të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve të tjerë në proces
- b. Merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal.
- c. Mban procesverbalin e seancës gjyqësore në mënyrë elektronike dhe audio sipas programeve të implementuara në gjykatë, në përputhje me dispozitat proceduriale në fuqi;
- d. Regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.
- e. Përpilon akte, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim.
- f. Është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve sipas një rregulli të caktuar, si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur apo të nxjerrë nga gjykatat dhe gjyqtarët;
- g. Ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;
- h. Ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;
- i. Bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave gjyqësore;
- j. Ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave;
- k. Ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj të autorizuar nga Kryetari i Gjykatës, Keshilli i Gjykatës dhe Kancelari.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të gjykatave të kategorisë së parë (të lartë) pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brënda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “*Bachelor*”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën 1 vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

- c. Të ketë njohuri shumë të mira të përdorimit të kompjuterit.
- d. Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etikë të lartë komunikimi me të gjithë marrësit e shërbimit të Gjykatës, brenda dhe jashtë saj.
- e. Të jetë i aftë për të kryer në kohë detyrat e ngarkuara.
- f. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës.
- Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ose nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **02 Nentor 2023, ora 16:00.**

Mosparaqitja e plote e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Ne datën **06 Nentor 2023**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

II. NGRITJA NË DETYRË

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të Gjykatave të kategorisë së dytë (të mesme) dhe të tretë (të ulët) pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

II.1. KUSHTET PËR NGRITJEN NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- d. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda shërbimit civil gjyqësor;
- e. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- f. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- g. Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “*Bachelor*”;
- h. Të ketë përvojë prej të paktën 1 vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

- i. Të ketë njohuri shumë të mira të përdorimit të kompjuterit.
- j. Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etikë të lartë komunikimi me të gjithë marrësit e shërbimit të Gjykatës, brenda dhe jashtë saj.
- k. Të jetë i aftë për të kryer në kohë detyrat e ngarkuara.
- l. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dokumentat si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës.
- Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ose nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **02 Nentor 2023, ora 16:00.**

Mosparaqitja e plote e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Ne datën **06 Nentor 2023**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e ngritjes ne detyre dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes ne detyre dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

II.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

II.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

III. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, rezultojnë se ende ka pozicione vakant, keto pozicione janë te vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës.

III.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “*Bachelor*”;
- b. Të ketë përvojë prej të paktën 1 vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën ose prokurorinë.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira të përdorimit të kompjuterit.
- d. Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etike të lartë komunikimi me të gjithë marrësit e shërbimit të Gjykatës, brenda dhe jashtë saj.
- e. Të jetë i aftë për të kryer në kohë detyrat e ngarkuara.
- f. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

III.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- CV e përditësuar.
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës.
- Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë e-mail) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Vërtetim banimi.
- Vërtetimin se nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ose nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **09 Nentor, ora 16:00.**

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

III.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Ne datën **13 Nentor 2023**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

III.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Kodi i Procedurës Civile;
- b. Kodi i Procedurës Penale;
- c. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,
- d. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

III.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, [ëëë.gjykata.gov.al](http://eëë.gjykata.gov.al).

KËSHILLI I GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM